



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1602 Prot

Tiranë, më 14/10/2019

REKOMANDIM

Nr. 42, datë 14/10/2019

**PËR PROGRAMIN E TRANSPARENCËS
SË AUTORITETIT PUBLIK "KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E
SHËRBIMIT CIVIL"**

Në mbështetje të neneve 6, 7 të Ligjit 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", shkronjës f) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të ligjit 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka kryer monitorimin on-line në faqen zyrtare <https://www.kmshc.al/programi-i-transparences/>, të autoritetit publik "Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Autoritetet Publike bazuar në pikën 1 të nenit 4 të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", kanë detyrimin të vënë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publik të këtij informacioni.

Gjithashtu, bazuar në pikën 2 të po të njëjtës dispozitë, në përgatitjen e programit të transparencës, Autoriteti Publik mban parasysh interesin më të mirë të publikut dhe sidomos:

- a) garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik;
- b) vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion;
- c) modelet e miratuara për kategorinë e autoritetit publik nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të këtij ligji.

Ky program, vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Autoriteti Publik ndërton dhe rrit transparencën në veprimtarinë e tij institucionale, nëpërmjet përditësimit dhe pasurimit të vazhdueshëm të Programit të Transparencës, në referencë edhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit".

Në përputhje me programin e transparencës të miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e informacionit të përcaktuara në nenin 7 të ligjit të sipërcituar.

Në kuadër të respektimit të detyrimeve të përcaktuara në ligj, u krye monitorimi me qëllim verifikimin e zbatimit të programit të transparencës në faqen zyrtare të autoritetit publik. Nga monitorimi rezultoi se, Autoriteti Publik ka publikuar në shiritin e menu-së kryesore, menu-në "Transparenca", si dhe e ka ndërlidhur atë me programin e transparencës.

Nga verifikimi i rubrikave të programit rezultoi se, kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t'u bërë publik pa kërkesë në përputhje me nenin 7 të ligjit, janë pasqyruar në mënyrë jo të plotë në programin e transparencës.

Programi i transparencës duhet të jetë i plotësuar me të gjithë elementët sikurse parashikohet në ligj si dhe i plotësuar me informacion specifik sipas fushës së veprimtarisë së çdo Autoriteti Publik.

Në lidhje me monitorimin e kryer, Zyra e Komisionerit vlerëson se problematikat e evidentuara konsistojnë në mosvënien në zbatim të programit të transparencës, në përputhje me modelin e miratuar nga Komisioneri.

Nga monitorimi u konstatua se nuk është publikuar informacioni në përputhje me nenin 7 pika 1 e ligjit, konkretisht për gërmat:

c) informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;

dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera;

ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit /partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, "Për prokurimin publik", dhe të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj; iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;

f) informacion për shërbimet që Autoriteti Publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit;

gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;

h) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor Autoriteti Publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;

i) regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji. Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve është publikuar por nuk është i përditësuar (përditësimi i fundit shtator 2018);

k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh;

l) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga Autoriteti Publik.

Disa kategori të informacionit publik sipas kërkesave të nenit 7 pika 1 e ligjit, gjenden të publikuara në rubrika të tjera të faqes por nuk janë të ndërlidhura me tabelën e programit (të pa linkuar). Konkretisht si më poshtë:

a) Një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik;

b) tekstet e plota të: i) konventave që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë; iii) akteve nënligjore; iv) kodeve të sjelljes; v) çdo dokumenti politikash; vi) manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik dhe që prek publikun e gjerë;

d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;

e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit;

Në përfundim, bazuar në provat dhe konstatimet që rezultuan nga monitorimi, u hartua raporti i monitorimit.

Komisioneri vlerëson se, pavarësisht se një pjesë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë është publikuar në faqen zyrtare, Autoriteti Publik duhet ti përmbahet programit model të transparencës të miratuar nga Komisioneri.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 4, 5, 6, 7 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", shkronjës f) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar,

REKOMANDOJ :

1. Autoriteti Publik/Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të gërmave a), b), c) të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 5 të ligjit 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të rishikojë/përditësojë programin e transparencës;
2. Autoriteti Publik duhet të pasqyrojë, në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7 të ligjit;
3. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 1 dhe 2 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 90 (nëntëdhjetë) ditor nga momenti i marrjes dijeni;
4. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 18, 19 dhe 20 të ligjit nr. 119/2014, "Për të Drejtën e Informimit".

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 14.10.2019.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi



Raport monitorimi mbi implementimin e programit të transparencës së Autoritetit Publik/ Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

1. Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka publikuar programin e transparencës në faqen zyrtare në linkun: <https://www.kmshe.al/programi-i-transparences/>




2. Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve nuk është i përditësuar (përditësimi i fundit shtator 2018)

KMSHC					
PROGRAMI I TRANSPARENCËS					
INFORMACION					
12	31.03.2017	Kërkesë për informacion	06.04.2017	E përfunduar	Nuk ka
13	10.04.2017	Kërkesë për informacion	11.04.2017	E përfunduar	Nuk ka
14	08.09.2017	Kërkesë për informacion	08.09.2017	E përfunduar	Nuk ka
15	26.10.2017	Kërkesë për njohjen e zbatimit të Vendimit Nr.102, datë 16.09.2017	30.10.2017	E përfunduar	Nuk ka
16	22.01.2018	Kërkesë për informacion	23.01.2018	E përfunduar	Nuk ka
17	03.09.2018	Kërkesë për informacion	11.09.2018	E përfunduar	Nuk ka

3. Programi i transparencës është i publikuar në përputhje me programin model të transparencës të miratuar sipas Urdhërit nr.14 date 22.01.2015. Bazuar në nenin 7 të ligjit është pasqyruar ikona "Transparenca" në faqen zyrtare të Autoritetit Publik, por informacioni i bërë publik në programin model të transparencës nuk është plotësisht i ndërlidhur.

TABELA E FUNKSIONEVE, DETYRAVE DHE KOMPETENCAVE TE DREJTORISE					
Kategoritë e informacionit publik po kërkave	Baza ligjore	Dokumenti/Përmbajtja	Afeti kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Sektori Përgjegjës për Përgatitjen e Materialit apo disponimin e tij
Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik	Neni 7/1/a	-Vendim miratimi -Struktura -Organika -Tabelat e funksioneve, detyrave dhe kompetencave të dëftorëve/ve, anëtarit, kualifikimet e dëftorëve	Pas botimit në t/zzyrtare Porditeohat pas çdo akt emërimi	Në faqen zyrtare në menunë "Rrëth nesh"	Specialiteti i Marrëdhënieve me Publikun dhe Shërbimeve Njëzore
Akte ndërkombëtare, ligje akte nën ligje, dokument politikash, dokument tjetër	Neni 7/1/b Neni 38/a i ligjit nr. 9987, datë 10.03.2008 i ndëryhuar	Konventa Ligje VKM Kod i sjelljes Raport vjetor	Pas botimit në t/zzyrtare Pas miratimit të udhëz nga Komisioneri Mënyrë: pas dëftimit në Kurvend	Në faqen zyrtare në menunë "Legjislacioni" Në faqen zyrtare në menunë "Legjislacioni" Në faqen zyrtare në menunë "Publikime"	KMSHC dhe Institucionet të tjera
Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, udhëzimet postare dhe elektronike për depozitim të kërkesave për informim, si dhe procedurat e anëtarit të vendimit të postës	Neni 7/1/c/g	Format kërkesë Adresë postare: Rruga "Abdi Toptani", ish-Katol "Drini", Tiranë Orazi: E hënë - E premte 08:00 - 18:00 Adresë e-mail: info@kmshe.d	Pas miratimit të Programit të transparencës, Mënyrë: në rast ndëryshimeve	Në faqen zyrtare në menunë "E drejta për informim"	Specialiteti i Marrëdhënieve me Publikun dhe Shërbimeve Njëzore

7.1.a) Një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik. Informacioni gjendet i publikuar në rubrikë tjetër të faqes së autoritetit;




7.1.b) tekstet e plota: i) të konventave që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë; ii) të ligjeve; iii) të akteve nënligjore; iv) të kodeve të sjelljes; v) të çdo dokumenti politikash; vi) të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik dhe që prek publikun e gjerë. Informacioni gjendet i publikuar në rubrikë tjetër të faqes së autoritetit;



7.1c) informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës; **Nuk është publikuar procedura e ankimit; Kërkesa për informim duhet kërkuar me search, pasi nuk gjendet në menunë e cituar në program.**



7.1.ç) të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinators për të drejtën e informimit;
Informacioni është publikuar në faqe.



7.1.dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit; Informacioni gjendet publikuar pjesërisht në faqe; **Nuk janë publikuar raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera.**



RAPORTE TË FINANCËS

RAPORT
MONITORIMI JANAR
- PRILL 2019(Kliko për të shkarkuar
pdf)RAPORT
MONITORIMI JANAR
- DHJETOR 2018(Kliko për të shkarkuar
pdf)RAPORT
MONITORIMI JANAR
- QUSHT 2018(Kliko për të shkarkuar
pdf)RAPORT
MONITORIMI JANAR
- PRILL 2018(Kliko për të shkarkuar
pdf)RAPORT
MONITORIMI JANAR
- DHJETOR 2017(Kliko për të shkarkuar
pdf)RAPORT MONITORIMI MAJ
- QUSHT 2017

(Kliko për të shkarkuar pdf)

RAPORT MONITORIMI
JANAR - PRILL 2017

(Kliko për të shkarkuar pdf)

RAPORT MONITORIMI
JANAR - DHJETOR 2016

(Kliko për të shkarkuar pdf)

RAPORT MONITORIMI
JANAR - SHTATOR 2016

(Kliko për të shkarkuar pdf)

11:15 AM
8/15/2019

RAPORTIME TË TJERA

RAPORT PËR MBIQËYRJEN
E ADMINISTRIMIT TË
SHËRBIMIT CIVIL DHE
MONITORIMIN E SJELLJES
SË NËPUNËSIT CIVIL NË
KUSHTET E ZQJEDHJEVE
POLITIKE PËR KUVENDIN E
SHQIPËRISE

(Kliko për të shkarkuar pdf)

RAPORT I KOMISIONERIT
PËR VITIN 2015 - TAKIMI I
5-TË I GP PËR RAP

(Kliko për të shkarkuar pdf)

KONTAKT

shqiperia

11:54 AM
8/15/2019

KMSHC KRETHI I NESH LEGJISLACIONI PROGRAMI I TRANSPARENCES PUBLIKIME INFORMACIONE KONTAKT

STRATEGJI TË NDRYSHME

RAPORTE

Raportimi të Financës
Raportimi të tjera
Strategji të ndryshme

STRATEGJIA E MENAXHIMIT TË RISKUT 2017-2019

(Kliko për të shkarkuar pdf)

KONTAKT

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" ish-hotel "Drini", Tiranë
E-mail: info@kmshc.al
Tel: 042 288 141

shqipëria
JO!
DUHANIT

11:06 AM
8/19/2019

KMSHC KRETHI I NESH LEGJISLACIONI PROGRAMI I TRANSPARENCES PUBLIKIME INFORMACIONE KONTAKT

RAPORTIMI VJETOR PËR KUVENDIN

RAPORT PËR VEPRIMTARINË E KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL 2018

(Kliko për të shkarkuar pdf)

RAPORT PËR VEPRIMTARINË E KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL 2017

(Kliko për të shkarkuar pdf)

RAPORT PËR VEPRIMTARINË E KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL 2016

(Kliko për të shkarkuar pdf)

RAPORT PËR VEPRIMTARINË E KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL 2015

(Kliko për të shkarkuar pdf)

RAPORT PËR VEPRIMTARINË E KOMISIONERIT PËR

11:05 AM
8/19/2019

e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara. **Informacioni është i publikuar në faqen zyrtare të autoritetit;**

The image displays two screenshots of the KMSHC (Komiteti Mbrojtës i Shëndetit Publik) website, showing the public information section. The top screenshot shows the 'PLANI VJETOR I PUNËS' (Annual Work Plan) section, and the bottom screenshot shows the 'BUXHETI' (Budget) section. Both sections feature a header with the KMSHC logo and navigation links, a main title, and a list of documents for download.

KMSHC
KURIA SHËNDETSHËSIE | LEGJISLACIONI | PROGRAMI I TRANSPARENÇES | PUBLIKIME | INFORMACIONE | KONTAKT

PLANI VJETOR I PUNËS

PUBLIKIME
Plani vjetor i punës
Queset
Përgjigjet
Udhëzime dhe interpretime

PLANI VJETOR I PUNËS 2019
(Kliko për të shkarkuar pdf)

PLANI VJETOR I PUNËS 2018
(Kliko për të shkarkuar pdf)

PLANI VJETOR I PUNËS 2017
(Kliko për të shkarkuar pdf)

PLANI VJETOR I PUNËS 2016
(Kliko për të shkarkuar pdf)

PLANI VJETOR I PUNËS 2015
(Kliko për të shkarkuar pdf)

BUXHETI

PUBLIKIME
Plani vjetor i punës
Queset
Përgjigjet
Udhëzime dhe interpretime


PLANI BUXHETOR I KMSHC 2019
(Kliko për të shkarkuar pdf)

PLANI BUXHETOR I KMSHC 2018
(Kliko për të shkarkuar pdf)

PLANI BUXHETOR I KMSHC 2017
(Kliko për të shkarkuar pdf)

PLANI BUXHETOR I KMSHC 2016
(Kliko për të shkarkuar pdf)

PLANI BUXHETOR I KMSHC 2015
(Kliko për të shkarkuar pdf)



ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit /partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj; iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme. **Informacioni nuk është i publikuar në faqe;**

f) informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit - **Informacioni nuk është publikuar në faqe pavarësisht se citohet në tabelën e programit model të transparencës;**

g) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik. **Nuk është publikuar përshkrimi i procedurës së bërjes së ankesës;**

gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik. **Informacioni nuk është i publikuar në faqe;**

h) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë. **Informacioni nuk gjendet i publikuar në faqe;**

i) regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji – Informacioni është publikuar por nuk është i përditësuar;

The screenshot displays the KMSHC website. At the top, there is a navigation bar with links: KMSHC, BRETH NËSH, LEGJISLACIONI, PROGRAMI I TRANSPARENCËS, PUBLIKIME, INFORMACIONE, and KONTAKT. Below the navigation bar is a large banner with the text "REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE". Underneath the banner is a table with the following columns: Nr. Rënder, Data e regjistrimit të kërkesës, Objekti, Data e kthimit të përgjigjes, Statusi i kërkesës, and Tarifa.

Nr. Rënder	Data e regjistrimit të kërkesës	Objekti	Data e kthimit të përgjigjes	Statusi i kërkesës	Tarifa
01	08.07.2015	Kërkesë për informacion	29.07.2015	E përfunduar	Nuk ka
02	16.07.2015	Kërkesë për marrje informacioni	29.07.2015	E përfunduar	Nuk ka
03	31.07.2015	Kërkesë për marrje informacioni	07.08.2015	E përfunduar	Nuk ka
04	19.8.2015	Kërkesë për informacion	23.11.2015	E përfunduar	Nuk ka
05	16.01.2016	Kërkesë për informacion	27.01.2016	E përfunduar	Nuk ka
12	31.03.2017	Kërkesë për informacion	06.04.2017	E përfunduar	Nuk ka
13	10.04.2017	Kërkesë për informacion	11.04.2017	E përfunduar	Nuk ka
14	08.09.2017	Kërkesë për informacion	08.09.2017	E përfunduar	Nuk ka
15	26.10.2017	Kërkesë për njatjen e zbatimit të Vendimit Nr.322, datë 16.09.2017	30.10.2017	E përfunduar	Nuk ka
16	22.01.2018	Kërkesë për informacion	23.01.2018	E përfunduar	Nuk ka
17	03.09.2018	Kërkesë për informacion	11.09.2018	E përfunduar	Nuk ka

Below the table, there is a section titled "KONTAKT" with the following information:

Adresa: Rruga "Abdi Toptari" ish-hotel "Drin", Tiranë
E-mail: info@kmshe.al
Tel: 042 288 141

There is also a logo for "Shqipëria JO! DUHANIT" and a copyright notice "COPYRIGHT KMSHC 2018".

k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh - Informacioni gjendet në faqe por nuk është publikuar sipas formatit të programit model të transparencës;

l) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik. **Informacioni gjendet në faqe por nuk është publikuar sipas formatit të programit model të transparencës;**

Autoriteti Publik	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil
Programi i transparencës	Po
Koordinatori	Po
7.1.a/d Përshkrim të struktura, funksioni dhe detyrat	Po
7.1.b: Tekste të plota të konventave, ligj, të akteve	Po(i pa linkuar)
7.1.c Procedura për kërkesë për informacion e ankesë për veprimtarinë e AP	Pjesërisht
7.1.ç Të dhënat e vendndodhjes AP	Po
7.1.dh Auditi	Jo
7. 1.e Buxheti	Po
7.ë Procedura e prokurimit	Jo
7.1.f Shërbimet e Autoritetit Publik	Jo
7.1.gj Mekanizma për dhënien e mendimeve	Jo
7.1.h Mbajtja e dok(Arkiva)	Jo
7.i Regjistri i kërkesave	Pjesërisht (i pa përditësuar)
7.1.k Dokumente që kërkohen shpesh	Po(i pa linkuar)
7.1.l Çdo Informacion i dobishëm	Po(i pa linkuar)